VENDIM
Nr. 210, datë 8.10.2021

MBI MOSFILLIMIN E PROCEDURËS PËR LICENCIMIN E SHOQËRISË "HEC TERFOJA" SHPK NË VEPRIMTARINË E TREGTIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE

Në mbështetje të nenit 16 dhe nenit 37, pika 2, germa "d", të ligjit nr. 43/2015, "Për sektorin e energjisë elektrike", të ndryshuar; të nenit 4, pika 1, germa "e"; të nenit 5, pika 1, germa "e" dhe të nenit 10, pika 3, të "Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike", të miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 109, datë 29.6.2016, të ndryshuar, si dhe të nenit 19, pika 1, germa "a", të "Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s", miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016, Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 8.10.2021, mbasi shqyrtoi relacionin nr. 129/4 prot., datë 6.10.2021, të Drejtorisë së Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, mbi "Fillimin e procedurës për licencimin e shoqërisë 'HEC Terfoja' sh.p.k., në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike",

konstatoi se:

- Shoqëria "HEC Terfoja" sh.p.k., me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 879 prot., datë 11.8.2021, ka paraqitur aplikimin për t'u pajisur me licencë në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike.

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 176, datë 23.8.2021, vendosi të mosfillojë procedurën për licencimin e shoqërisë "HEC Terfoja" sh.p.k., në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike, për arsye të moskryerjes së pagesës së aplikimit.

- Në vijim të kësaj vendimmarrjeje, ERE ka njoftuar shoqërinë me shkresën nr. 879/1 prot., datë 31.8.2021, dhe i ka bërë me dije se, në mbështetje të parashikimit të nenit 10, pika 7, të "Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike", mund të paraqesë një aplikim të ri, brenda 1 (një) muaji nga marrja e vendimit të ERE-s për mosfillimin e procedurës, për shqyrtimin e aplikimit, dhe dokumentacioni i paraqitur për aplikimin e mëparshëm do të konsiderohet i vlefshëm edhe për aplikimin e ri, i cili duhet të përmbajë bashkëlidhur edhe pagesën e aplikimit për licencim.

- Në përgjigje të njoftimit të ERE-s, shoqëria, me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 879/2 prot., datë 1.10.2021, ka dokumentuar kryerjen e pagesës së aplikimit për t'u pajisur me licencë nga ERE, në zbatim të aneksit A, të "Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike".

- Nga analiza e dokumentacionit, në fazën e fillimit të procedurave të licencimit në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike, për shoqërinë "HEC Terfoja" sh.p.k., rezulton se ka mungesa të theksuara në dokumentacion, në lidhje me kërkesat e "Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike", si më poshtë:

- Formati dhe dokumentacioni për aplikim, neni 9, pika 1, germat: "a", "b" dhe "c", plotësuar;

- Dokumentacioni financiar dhe fiskal, neni 9, pika 3, germat: "b", "d", plotësuar;

- Dokumentacioni i munguar ka të bëjë me:

- nenin 9, pika 2, dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor:

- germat: "a"/"b" (akti i themelimit/statuti), plotësuar pjesërisht. Shoqëria "HEC Terfoja" sh.p.k., nuk ka depozituar aktin e themelimit të saj në ERE;

- germa "c" (vërtetimi për regjistrim dhe ekstrakt historik nga Qendra Kombëtare e Biznesit, QKB), plotësuar pjesërisht. Shoqëria nuk ka depozituar në ERE ekstraktin historik të saj me datë të

përditësuar, në zbatim të nenit 8, pika 3, të rregullores, si dhe certifikatën e regjistrimit pranë QKB-së;

- germa "d" (vërtetimi nga prokuroria dhe gjykata për përfshirje ose jo në një proces penal të drejtuesve të shoqërisë), plotësuar pjesërisht. Shoqëria nuk ka depozituar në ERE vërtetimet e gjykatës dhe të prokurorisë me data të përditësuara, dhe gjithashtu edhe vërtetimin e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kukës dhe Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Kukës për vetë shoqërinë "HEC Terfoja" sh.p.k., si dhe për administratorin tjetër të shoqërisë;

- germa "e" (struktura e ndërtimit dhe funksionimit administrativ të shoqërisë, sipas pozicioneve dhe profileve përkatëse), pa plotësuar. Shoqëria nuk ka përcjellë në ERE strukturën e organizmit të saj;

Nenin 9, pika 3, dokumentacioni financiar dhe fiskal:

- germa "a" (vërtetimi për shlyerjen e tatim-taksave dhe detyrimeve ndaj Institucionit të Sigurimeve Shoqërore), plotësuar pjesërisht. Shoqëria nuk ka paraqitur vërtetimin e Drejtorisë Rajonale Tatimore Kukës me datë të përditësuar (ky vërtetim mban datë të hershme në kundërshtim me parashikimin e nenit 8, pika 3, të rregullores) dhe nuk ka paraqitur vërtetimin e shlyerjes së detyrimeve ndaj sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore;

- germa "c" (dokumente që vërtetojnë aftësinë ose mbështetjen financiare të aplikuesit, ku shprehen qartë vlerat monetare për financim dhe struktura e financimit (financim i vetë aplikuesit, kredi bankare, donacion, të tjera, etj.), pa plotësuar. Shoqëria nuk ka depozituar asnjë dokument në lidhje me këtë kërkesë të rregullores;

Nenin 9, pika 4.8, dokumentacioni teknik për veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike:

- germat: "a"/"d" (sasia e energjisë elektrike e parashikuar për t'u tregtuar në gWh/sipas viteve), pa plotësuar. Shoqëria nuk ka paraqitur sa kërkohet nga kjo pikë e rregullores;

- germa "b" (kapitali financiar i parashikuar për ushtrimin e këtij aktiviteti), plotësuar pjesërisht. Shoqëria nuk ka specifikuar kapitalin që do të vinte në dispozicion të veprimtarisë së tregtimit të energjisë elektrike;

- germa "c" (lista e kontratave të mëparshme, nëse ka pasur), pa plotësuar. Shoqëria nuk ka ushtruar më parë veprimtari në fushën e energjisë dhe si e tillë nuk mund të disponojë kontrata të realizuara më herët. Megjithatë duhet të bënte plotësimin e kësaj kërkese të rregullores në formë deklarative, sikurse vijohet nga subjektet të cilët nuk e kanë ushtruar ndonjëherë këtë veprimtari.

- Nëse shoqëria "HEC Terfoja" sh.p.k. paraqet një aplikim të ri, në respektim të kërkesave të "Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike", në zbatim të nenit 10, pika 7, të po kësaj rregulloreje, edhe pagesa për aplikim do të konsiderohet e vlefshme për aplikimin e ri.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të mosfillojë procedurën për licencimin e shoqërisë "HEC Terfoja" sh.p.k. në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike.

2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Për këtë vendim mund të kërkohet rishikim në ERE brenda 7 ditëve kalendarike, si dhe mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti